



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2019:081996  
Datë: 14.03.2024  
Numri i dokumentit: 05450334

C.nr.228/19

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim BALAJ, në çështjen kontestimore të paditësve N.H., dhe N.H., qe te dy nga Gjakova, kundër të paditurës N.P.T “...” sh.p.k., me seli në Prishtinë - njësia në Gjakovë, të cilën me autorizim e përfaqëson Urim Pozhegu, avokat në Gjakovë, me objekt kontesti: kompensim dëmi, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 14 mars 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e udhëhequr nën shenjën 228/19 e datës 22.03.2019 e paraqitur nga ana e paditësve N.H., dhe N.H., qe te dy nga Gjakova kundër të paditurës N.P.T “...” sh.p.k., me seli në Prishtinë - njësia në Gjakovë, për kompensim demi.

II. DETYROHEN paditësit që në emër të shpenzimeve të procedurës, të paditurës solidarisht t’ia kompensojnë shumën prej 1,092.00 euro, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcenim të përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësit me datë 22.03.2019 kanë parashtruar padi, kundër të paditurës N.P.T “...” sh.p.k., me seli në Prishtinë - njësia në Gjakovë, me objekt kontesti: kompensim dëmi.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën nuk ka prezantuar askush nga paditësit, përkundër faktit se të njëjtit kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e datës 14.03.2024, siç u provua nga fletë dërgesa për dorëzim personal, e dorëzuar nga ana e shërbimit postar të kësaj gjykate, e pranuar nga familjarët e paditësve me datë 23.02.2024, mirëpo mos prezencën për seancë nuk e kanë paralajmëruar dhe arsyetuar në asnjë formë.

Në seancën e shqyrtimit kryesor ka prezantuar i autorizuari i të paditurës, i cili ka deklaruar se meqenëse sipas aktvendimit procedural te datës 22.02.2024 paditësit janë ftuar në mënyrë të rregullt me adresa të dhëna si në padi dhe se personi që ka pranuar ftesat e gjykatës është bashkëshortja e paditësit të parë, përkatësisht kunata e paditësit të dytë e meqenëse ky dorëzim konsiderohet i rregullt sipas dispozitave të LPK-së, si dhe nuk e kanë arsyetuar mungesën në këtë seance gjyqësore, i propozoj gjykatës që përmes aktvendimit në kuptim të nenit 423 par. 3, të LPK-së konsiderohet se palët kanë tërhequr padinë dhe nuk kanë interes juridik për vazhdimin e kësaj çështje kontestimore, andaj ndaj të paditurës padia duhet të konsiderohet e tërhequr dhe kjo çështje të konsiderohet e mbyllur.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: për përgjigje ne padi 156 euro për 4 seanca të mbajtura 4x208 euro, shumen prej 832 euro dhe 1 seancë e shtyrë prej 104 euro, gjithsej shumën e përgjithshme prej 1092 euro.

Meqenëse paditësit sipas konstatimit të lartcekur kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa mungesën nuk e kanë paralajmëruar dhe arsyetuar, duke u bazuar në nenin 423 paragrafi 3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, në të cilin është paraparë se *“Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit”*, gjykata vendosi që padinë e paditësve ta konsideroj të tërhequr.

Kur gjykata vendosi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 452 dhe 456 paragrafi 1 të LPK-së, ashtu që vendosi që të detyrohen paditësit solidarisht në kompensimin e shpenzimeve procedurale dhe atë: për përgjigje ne padi 156.00 euro, për 4 seanca të mbajtura nga 208.00 euro për secilën seancë, shumën prej 832.00 euro, si dhe për një seancë të shtyrë prej 104.00 euro, e gjithsej shumën prej 1,092.00 euro.

Nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.228/19, me 14 mars 2024

GJ Y Q T A R

Durim BALAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të te njëjtit në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.